

V E N D I M
Nr. 168, datë 26.07.2002

“NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Zija Vuci	Anëtar i “““
Gjergj Sauli	Anëtar i “““
Alfred Karamuço	Anëtar i “““
Kristofor Peçi	Anëtar i “““
Kujtim Puto	Anëtar i “““
Petrit Plloçi	Anëtar i “““
Sokol Sadushi	Anëtar i “““

me sekretare Arbenka Lalice, në datën 12.7.2002, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.124 Akti që i përket:

KËRKUES:ANASTAS KOSTRICA, përfaqësuar nga avokat Isllam Llapi, me prokurë.

SUBJEKTE TË INTERESUARA: 1. BASHKIA FIER, në mungesë.

2. MEDIHA MERDANI, përfaqësuar nga avokat Shpëtim Baçi, me prokurë.

OBJEKTI:Shfuqizimi si antikushtetues i vendimit nr.152, datë 15.2.2002 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

Kërkuesi pretendon se vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë është antikushtetues, sepse i ka mohuar të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, si dhe të drejtën e mbrojtjes.

Ai pretendon:

- Në rekursin drejtuar Gjykatës së Lartë ka parashtruar se gjykatat kanë zbatuar gabim ligjin për kthimin e pronave dhe, konkretisht, nuk kanë zbatuar drejt nenet 4 dhe 15 të tij. Ky zbatim i gabuar që gjykatat i kanë bërë ligjit ka qenë i mjaftueshëm për Kolegjin Civil të Gjykatës së Lartë që çështjen ta kalonte për shqyrtim në seancë gjyqësore.

- Shteti ia ka shitur truallin nën një objekt të përkohshëm dhe pa themele subjektiviteti të interesuar, ndërkohë që pronari i truallit, sipas ligjit për kthimin e pronave, e kishte të drejtën për ta gëzuar vetë këtë pronë.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Sokol Sadushi, përfaqësuesin e kërkuesit, të subjektiviteti të interesuar dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Komisioni i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Fier i ka njohur pronësinë kërkuesit mbi një sipërfaqe 3114 m², me të drejtë kompensimi, sepse trualli ka qenë i zënë. Kërkuesi e ka kundërshtuar këtë vendim të Komisionit të Kthimit të Pronave në gjykatë, për arsye se brenda truallit ka patur sipërfaqe të lira, mbi të cilat janë ngritur ndërtime pa leje.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier i ka rrëzuar padinë. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Vlorë. Kundër këtij vendimi është ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë, e cila me vendimin nr.152, datë 15.2.2002, ka vendosur në dhomën e këshillimit mospranimin e rekursit.

Pretendimet që ka ngritur kërkuesi përpara Gjykatës Kushtetuese nuk lidhen me shkeljen e të drejtës për një proces të rregullt ligjor. Gjykata Kushtetuese çmon të nevojshme të theksojë se jurisprudenca e saj kushtetuese është konsoliduar tashmë në drejtim të krijimit të një koncepti sa më të

qartë të të drejtës kushtetuese për proces të rregullt ligjor, duke orientuar dhe argumentuar se jo çdo shkelje procedurale apo ligjore prek detyrimisht këtë parim kushtetues.

Pretendimet e ngritura nga kërkuesi lidhen me aspekte të të provuarit e me zgjidhjen në themel të çështjes dhe nuk kanë të bëjnë me cenimin e të drejtës kushtetuese të tij për një proces të rregullt ligjor. Mënyra e vlerësimit të provave, që përbën pretendimin kryesor në kërkesën e paraqitur dhe që lidhet me faktin nëse trualli ndërmjet pallateve ka qenë i lirë apo i zënë, pretendim i cili është ngritur edhe në rekursin drejtuar Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, përbën një atribut të gjykimit të kryer nga gjykatat e sistemit të zakonshëm dhe nuk mund të përfshihet në jurisprudencën kushtetuese. Sipas nenit 480 të Kodit të Procedurës Civile, është e drejtë e Kolegjit Civil në dhomën e këshillimit të analizojë dhe vlerësojë përputhjen me kërkesat e ligjit të shkaqeve të ngritura në rekurs. Analiza që bën Kolegji nuk mund t'i heqë atij të drejtën për të vendosur mospranimin e rekursit, kur bindet se shkaqet e ngritura në rekurs nuk lidhen me çështje të ligjit, por me mënyrën e të vlerësuarit të provave nga gjykatat e hallkave më të ulëta.

Në këto kushte, marrja nga Gjykata Kushtetuese e attributeve të gjykatave të zakonshme, pavarësisht nga zgjidhja që ato i japin çështjeve në fakt, por që nuk lidhen me parimin kushtetues të një procesi të rregullt ligjor, do ta spostonte këtë Gjykatë nga funksionet e saj.

Përfundimisht, Gjykata Kushtetuese çmon se kërkesa e paraqitur nga Anastas Kostrica, nuk është e drejtë dhe duhet rrëzuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 131/f e 132 të Kushtetutës, si dhe nenit 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

V E N D O S I:

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.